

Emri i produktit: WYROL 6
Data e rishikimit: 29 Dhj 2022
Faqe 1 nga 16

DËFTESË E SIGURISË TEKNIKE

SEKSIONI 1	IDENTIFIKIMI I LËNDËS / PËRZIERJES DHE I KOMPANISË / NDËRMARRJES
-------------------	---

Që prej datës së rishikimit më sipër, kjo (M)SDS (Dëftesë e Sigurisë (Materiale-)Teknike) i përmbush kërkesat e rregulloreve në Shqipëri.

1.1. IDENTIFIKUESI I PRODUKTIT

Emri i produktit: **WYROL 6**
Përshkrim i produktit: Hidrokarbure dhe Aditivë
Kodi i produktit: 201570204535, 661827-60

1.2. PËRDORIME RELEVANTE TË IDENTIFIKUARA TË LËNDËS OSE TË PËRZIERJES DHE PËRDORIME QË NUK KËSHILLOHEN

Destinimi i përdorimit: Aditiv i lëngshëm për përpunimin e metaleve

Përdorime të kundërrekomanduara: Ky produkt nuk rekomandohet për ndonjë përdorim industrial, profesional ose të konsumit të gjerë tjetër nga Përdorimet e identifikuara më lart.

1.3. HOLLËSI PËR OFRUESIN E DËFTESËS SË SIGURISË TEKNIKE

Furnizuesi: **ExxonMobil Petroleum & Chemical BV**
POLDERDIJKWEG
B-2030 ANTWERP
Belgjikë

Të Dhëna Teknike për Produktin: ++420 2 2145 6426

1.4. NUMRI I TELEFONIT PËR URGJENCA

Qendra Kombëtare e Kontrollit të Helmimeve:

SEKSIONI 2	TITULLI IDENTIFIKUES I RREZIKSHMËRISË
-------------------	--

2.1. KLASIFIKIMI I LËNDËS OSE I PËRZIERJES

Klasifikimi sipas Rregullores (EC) No. 1272/2008

Toksikant me aspirim: Kategoria 1., H304: Mund të jetë fatale po të gëlltitet dhe të depërtojë në rrugët e frymëmarrjes.
Toksikant uhor akut: Kategoria 1., H400: Shumë toksik për gjallesat ujore.
Toksikant uhor kronik: Kategoria 2., H411: Toksik për gjallesat ujore me efekte afatgjata.

2.2. ELEMENTE TË ETIKETËS

Elementet e etiketës sipas Rregullores (EC) No 1272/2008

Piktogramet:

Emri i produktit: WYROL 6
Data e rishikimit: 29 Dhj 2022
Faqe 2 nga 16



Fjalë sinjalizuese: Rrezik

Deklarata të rrezikshmërisë:

Shëndeti:

H304: Mund të jetë fatale po të gëlltitet dhe të depërtojë në rrugët e frymëmarrjes.

Mjedisi:

H400: Shumë toksik për gjallesat ujore.

H411: Toksik për gjallesat ujore me efekte afatgjata.

Shtesë:

EUH066: Ekspozimi i përsëritur mund të shkaktojë tharje ose plasaritje të lëkurës.

Deklarata paralajmëruese:

Parandalimi:

P273: Shmangni çlirimin në mjedis.

Përgjigja:

P301 + P310: PO TË GËLLTITET: Merrni menjëherë në telefon një QENDËR HELMIMI ose një mjek/punonjës shëndetësor.

P331: MOS provokoni të vjellë.

P391: Grumbullojini derdhjet.

Magazinimi:

P405: Ruajeni të mbyllur me çelës.

Asgjësimi:

P501: Eliminoni përmbajtjen dhe enën në pajtim me rregulloret lokale.

Përmban: Hidrokarbure, C11-C14, n-alkane, izoalkane, ciklike, <2% aromatike

2.3. RREZIKSHMËRI TË TJERA

Rrezikshmëri Fizike / Kimike:

Materiali mund të grumbullojë elektricitet statik, çka mund të shkaktojë zjarr. Materiali mund të çlirojë avuj që formojnë menjëherë përzierje të ndezshme. Avujt e grumbulluar mund të flakërojnë dhe/ose të shpërthejnë në rast se ndizen. I djegshëm.

RREZIKSHMËRIA PËR SHËNDETIN:

Ekspozimi i përsëritur mund të shkaktojë përtharje ose plasaritje të lëkurës. Mund të irritojë lëkurën, hundën, fytin dhe mushkëritë.

Rrezikshmëritë mjedisore:

Nuk ka rrezikshmëri të mëtejshme. Materiali nuk i përmbush kriteret për PBT ose vPvB në pajtim me REACH Annex XIII.

Emri i produktit: WYROL 6
 Data e rishikimit: 29 Dhj 2022
 Faqe 3 nga 16

Vetitë çrregulluese endokrine:

Nuk përmban asnjë substancë që njihet për vetitë çrregulluese endokrine.

SEKSIONI 3 PËRBËRJA / TË DHËNA PËR INGREDIENTËT

3.1. LËNDËT Nuk Zbatohet. Ky material rregullohet si përzierje.

3.2. PËRZIERJE

Ky material përkufizohet si përzierje.

Lëndë me rrezikshmëri të raportuar që përmbush(in) kriteret e klasifikimit dhe/ose me një cak ekspozimi (OEL)

Emri	CAS#	EC#	Regjistrimi#	Përqendrimi*	Klasifikimi GHS/CLP	Kufijtë e përqendrimeve specifike, faktorët shumëfishues dhe ATE-t
2,6-DI-TERT-BUTIL-P-KREZOL	128-37-0	204-881-4	01-2119565113-46	0.1 - < 1%	Aquatic Acute 1 H400 (M factor 1), Aquatic Chronic 1 H410 (M factor 1)	-
Hidrokarbure, C11-C14, n-alkane, izoalkane, ciklike, <2% aromatike	-	926-141-6	01-2119456620-43	10 - < 20%	[Flam. Liq. 4 H227], Asp. Tox. 1 H304, EUH066	-
ACID DODEKANOIK, METIL ESTER	111-82-0	203-911-3	01-2119487989-06	80 - < 90%	Aquatic Acute 1 H400 (M factor 1), Aquatic Chronic 2 H411	-

Shënim - çdo klasifikim në kllapa katrore është një bllok ndërtues i GHS i pa-adoptuar nga BE në rregulloren CLP (Nr. 1272/2008) dhe që, për këtë arsye, nuk zbatohet në BE dhe në vendet jo-BE që kanë implementuar rregulloren CLP, por jepet këtu vetëm për qëllime informacioni.

Shënim: Çdo element në kolonën EC# që nis me numrin "9" është një Numër Liste i Përkohshëm që jepet nga ECHA, në pritje të publikimit të Numrit zyrtar të Inventarit EC për substancën. Shihni Seksionin 15 për informacion të mëtejshëm në lidhje me numrin CAS për substancën.

SHËNIM: Shihni Seksionin 16 të (M)SDS për tekstin e plotë të deklaratave të rrezikshmërisë.

SEKSIONI 4 MASA TË NDIHMËS SË PARË

4.1. PËRSHKRIM I MASAVE TË NDIHMËS SË SHPEJTË

FRYMËTHITHJA

Largojeni nga ekspozimi i mëtejshëm. Ata që japin ndihmën, duhet t'i shmangen ekspozimit vetë. Përdorni mbrojtje të përshtatshme të rrugëve të frymëmarrjes. Në rast se viktimi ka irritim të rrugëve të frymëmarrjes, marrje mendsh, të përziera ose humbje ndjenjash, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore. Në rast ndalimi të

Emri i produktit: WYROL 6
Data e rishikimit: 29 Dhj 2022
Faqe 4 nga 16

frymëmarrjes, përdorni ndonjë pajisje mekanike për të nxitur ajrimin ose jepni frymëmarrje gojë-më-gojë.

KONTAKTI ME LËKURËN

Lajini me ujë dhe sapun zonat që kanë rënë në kontakt. Hiqini rrobet e ndotura. Lajini rrobet e ndotura para se t'i ripërdorni.

KONTAKTI ME SYTË

Shpëlajeni mirë me ujë. Në rast se ka iritrim, kërkoni ndihmë mjekësore.

GËLLTITJA

Kërkoni ndihmë mjekësore menjëherë. Mos provokoni të vjella.

4.2. SIMPTOMAT DHE EFEKTET MË TË RËNDËSISHME, AKUTE DHE TË VONUARA

Skuqje, plasaritje e thatë e lëkurës.

4.3. INDIKIM PËR KUJDESIN DHE TRAJTIMIN MJEKËSOR TË MENJËHERSHËM DHE TRAJTIMIN E POSAÇËM QË MUND TË DUHET

Po të gëlltitet, materiali mund të aspirohet në mushkëri dhe të shkaktojë pneumoni kimike. Trajtojeni sipas nevojës.

SEKSIONI 5

MASA KUNDËR ZJARRIT

5.1. MJETE FIKËSE

Mjete Fikëse të Përshtatshme: Për të fikur flakët, përdorni mjegull uji, shkumë, kimikat të thatë ose dyoksid karboni (CO₂).

Mjete fikëse të papërshtatshme: Rryma Uji të Drejtpërdrejta

5.2. RREZIKSHMËRI TË POSAÇME NGA LËNDA OSE PËRZIERJA

Produkte të Rrezikshme të Djegies: Aldehyde, Produkte të djegies së paplotë, Okside të karbonit, Tym, Tymra, Okside të sqfurit

5.3. KËSHILLA PËR ZJARRFIKËSIT

Udhëzime për Fikje Zjarri: Evakuojeni zonën. Mos lejoni që rrjedhat nga zjarrfikja ose hollimi të futen në vija ujore, kanale ujërash të zeza ose kanale të ujësjellësit. Zjarrfikësit duhet të përdorin pajisje mbrojtëse standard dhe, në hapësira të mbyllura, aparat frymëmarrës autonom (SCBA). Përdorni curril uji për të ftohur sipërfaqet e ekspozuar ndaj zjarrit dhe për të mbrojtur personelin.

Rrezikshmëri Zjarri e Pazakonshme: I djegshëm. Aerosolet e presurizuara mund të krijojnë një përzierje të ndezshme.

VETI TË NDEZSHMËRISË

Pika e Flakërimin [Metoda]: >70°C (158°F) [ASTM D-93]

Caqet e Poshtme/të Sipërme të Ndezshmërisë (% e përafërt e vëllimit në ajër): UEL (Kufiri i Sipërm i Ekspozimit): Nuk disponohen të dhëna LEL (Kufiri i Poshtëm i Ekspozimit): Nuk disponohen të dhëna

Temperatura e Vetëndezjes: Nuk disponohen të dhëna

SEKSIONI 6

MASA KUNDËR ÇLIRIMIT AKSIDENTAL

6.1. PARALAJMËRIME PERSONALE, PAJISJE MBROJTËSE DHE PROCEDURA TË URGJENCËS

PROCEDURA TË NJOFTIMIT

Në rast derdhjeje ose çlirimi aksidental, njoftoni autoritetet përkatëse, në pajtim me të gjitha rregulloret e zbatueshme.

MASA MBROJTËSE

Mos hyni në kontakt me materialin e derdhur. Njoftoni ose evakuoni banorët në zonat përreth ose në drejtim të erës, në rast se kjo bëhet e nevojshme për shkak të toksicitetit ose ndezshmërisë së materialit. Shihni Seksionin 5 për të dhëna të zjarfikjes. Shihni Seksionin e Identifikimit të Rrezikshmërisë për Rrezikshmëri Domethënëse. Shihni Seksionin 4 për Këshilla të Ndhmës së Parë. Shihni Seksionin 8 për udhëzime në lidhje me kërkesat minimale për pajisje mbrojtëse personale. Mund të dalë nevoja për masa mbrojtëse të mëtejshme, në varësi të rrethanave specifike dhe/ose gjykimit ekspert të ekipit të përgjigjes urgjente.

Për shërbimet e emergjencës: Mbrojtja për frymëmarrjen: mund të përdoret respirator me mbulim të fytyrës përgjysmë ose të plotë, me filtër/filtra për avull organik dhe, sipas rastit, H₂S; ose aparat frymëmarrjeje autonom (SCBA), në vartësi të madhësisë së derdhjes dhe nivelit potencial të ekspozimit. Në qoftë se ekspozimi nuk mund të karakterizohet plotësisht, ose ka të ngjarë ose pritet që atmosferës t'i mungojë oksigjeni, rekomandohet përdorimi i një aparati frymëmarrjeje autonom (SCBA). Rekomandohen doreza pune rezistente ndaj hidrokarbureve aromatike. Shënim: dorezat prej polivinil acetati (PVA) nuk janë rezistente ndaj ujit, prandaj nuk duhen përdorur në urgjenca. Rekomandohen syze mbrojtëse kundërkimike, në qoftë se ka rrezik spërkatjeje ose kontakti me sytë. Derdhje të vogla: rroba pune antistatike normale janë zakonisht të mjaftueshme. Derdhje të mëdha: rekomandohet uniformë për krejt trupin, prej materiali antistatik, rezistent ndaj kimikateve.

6.2. MASA MJEDISORE PARAPRAKE

Derdhje të mëdha: Ngrini diga penguese duke i paraprirë rrjedhës së derdhjes, që të mund ta izoloni dhe shkartinisni më pas. Mos lejoni të kalojë në vijat ujore, kanalet e ujërave të zeza, bodrumet ose zonat e mbyllura.

6.3. METODA DHE MATERIALE PËR KUFIZIMIN DHE PASTRIMIN

Derdhje Tokësore: Ndalojeni rrjedhjen, nëse mund ta bëni këtë pa u rrezikuar. Mos e prekni materialin e derdhur, as mos ecni mbi të. Derdhje të Vogla: Përthithni me dhë, rërë ose material tjetër të padjegshëm dhe transferoni në enë për të eliminuar më vonë.

Derdhje Ujore: Ndalojeni rrjedhjen, nëse mund ta bëni këtë pa u rrezikuar. Rrethojeni menjëherë vendin e derdhjes me pengesa notuese për ta shenjuar. Lajmëroni anijet dhe mjetet e tjera lundruese. Largojeni nga sipërfaqja me shumëheqje ose me anë materialesh përthithëse të përshtatshme. Para se të përdorni agjentë dispersivë, kërkoni këshillën e një specialisti.

Rekomandimet për derdhje ujore dhe tokësore mbështeten në skenarin më të gjasshëm për derdhje të këtij materiali; megjithatë, rrethanat gjeografike, era, temperatura (dhe në rast derdhjeje ujore) drejtimi dhe shpejtësia e valëve dhe e rrymave mund të kenë ndikim të madh në masat që duhen marrë. Për këtë arsye, duhen konsultuar ekspertët vendorë. Shënim: rregulloret lokale mund të përmbajnë kufizime ose detyrime për veprimet që duhen ndërmarrë.

6.4. REFERENCAT TE SEKSIONE TË TJERA

Shihni Seksionet 8 dhe 13.

SEKSIONI 7

TRAJTIMI DHE RUAJTJA

7.1. MASA PARAPRAKE PËR TRAJTIM TË SIGURTË

Emri i produktit: WYROL 6

Data e rishikimit: 29 Dhj 2022

Faqe 6 nga 16

Mos frymëthithni aerosolin ose avujt. Mos lejoni të bjerë në kontakt me lëkurën. Grimcat e vogla metalike nga përpunimi mekanik mund të shkaktojnë gërryerje të lëkurës dhe të krijojnë kushte për dermatit. Parandaloni derdhjet e vogla ose rrjedhjet, që të shmangni rrezikun e rrëshqitjes. Materiali mund të grumbullojë elektricitet statik, çka mund të shkaktojë shkëndija elektrike (burim zjarri). Kur materiali trajtohet në sasi të mëdha, shkëndijat elektrike mund t'u vënë zjarrin avujve të ndezshëm nga lëngje ose mbeturina që mund të jenë të pranishme (p.sh. gjatë operacioneve të ndërrim-ngarkimit). Përdorni procedura të përshtatshme të lidhjes shkarkuese dhe/ose tokëzimit. Megjithatë, lidhjet shkarkuese dhe tokëzimi mund të mos jenë në gjendje të mënjanojnë rrezikun e akumulimit statik. Këshillohuni me normat e zbatueshme lokale për t'u orientuar. Referenca të mëtejshme mund të merrni nga Instituti Amerikan i Naftës 2003 (American Petroleum Institute 2003) (Protection Against Ignitions Arising out of Static, Lighting and Stray Currents/Mbrojtja ndaj Zjarreve që Shkaktohen nga Elektriciteti Statik, Rrufetë dhe Rrymat e Pakontrolluara) ose Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Kundër Zjarrit 77 (National Fire Protection Agency 77) (Recommended Practice on Static Electricity/Praktikat e Këshilluara për Trajtimin e Elektricitetit Statik) ose CENELEC CLC/TR 50404 (Electrostatics – Code of practice for the avoidance of hazards due to static electricity/Elektrostatika – Kod i praktikave për shmangien e rreziqeve të elektricitetit statik).

Akumulator Statik: Ky material akumulon elektricitet statik.

7.2. KUSHTET PËR RUAJTJE TË SIGURT, DUKE PËRFSHIRË EDHE PAPAJTUESHMËRITË E MUNDSHME

Lloji i enës së përdorur për ta ruajtur materialin mund të ndikojë në akumulimin dhe shpërhapjen statike. Mbajeni enën të mbyllur. Trajtojini enët me kujdes. Hapini ngadalë, për të kontrolluar ndonjë çlirim të mundshëm trysnie. Ruajeni në një zonë të freskët, të ajruar mirë. Enët ku ruhet duhet të tokëzohen dhe të lidhen me kabëll mase. Enët e ruajtjes në magazinë, enët e transferimit dhe pajisjet shoqëruese duhet të tokëzohen dhe të bashkohen me lidhje shkarkuese, për të parandaluar akumulimin e elektricitetit statik.

7.3. PËRDORIME FINALE SPECIFIKE

Seksioni 1 informon për përdorimet finale të identifikuara. Nuk disponohen udhëzime specifike për industritë ose sektorët.

SEKSIONI 8 KONTROLLET E EKSPOZIMIT / MBROJTJA PERSONALE

8.1. PARAMETRA TË KONTROLLIT

VLERAT E KUFIJVE TË EKSPOZIMIT

Kufijtë/normat e ekspozimit (Shënim: kufijtë e ekspozimit nuk janë kumulativë)

Emri i Lëndës	Forma	Kufiri / Norma			SHËNIM	Burimi
2,6-DI-TERT-BUTIL-P-KREZOL	Fraksion dhe avull i frymëthit hshëm	TWA (Mesatar e Kohë-Peshë)	2 mg/m ³			ACGIH (Konferenca Amerikane e Higjienistëve Industrialë Qeveritarë)
HIDROKARBURE, C11-C14, N-ALKANE, IZOALKANE, CIKLIKE, <2% AROMATIKE [HIDROKARBURE GJITHSEJ]	Avull.	RCP - TWA	1200 mg/m ³	164 ppm		ExxonMobil

Shënim: Të dhënat për procedurat e këshilluara të mbikqyrjes mund t'u kërkojnë agjencisë (agjencive)/institutit (instituteve) përkatës(e):

Emri i produktit: WYROL 6
 Data e rishikimit: 29 Dhj 2022
 Faqe 7 nga 16

Inspektorati Shtetëror i Punës

NIVELI PA EFEKT I DERIVUAR (DNEL)/NIVELI I EFEKTIT MINIMAL I DERIVUAR (DMEL)

Punëtori

Emri i Lëndës	Dermal	Frymëthithje
Hidrokarbure, C11-C14, n-alkane, izoalkane, ciklike, <2% aromatike	NA	NA

Konsumatori

Emri i Lëndës	Dermal	Frymëthithje	Oral
Hidrokarbure, C11-C14, n-alkane, izoalkane, ciklike, <2% aromatike	NA	NA	NA

Shënim: Niveli i Efektit Minimal i Derivuar (DNEL) është një nivel i sigurt i ekspozimit, i përafuar, që derivohet nga të dhënat e toksicitetit në pajtim me direktivat specifike brenda rregullores europiane REACH. DNEL mund të jetë i ndryshëm nga Caku i Ekspozimit në Vendin e Punës (OEL) për të njëjtin kimikat. OEL-et mund të rekomandohen nga një kompani individuale, një organizëm rregullator qeveritar ose një organizëm ekspert, si p.sh. Komiteti Shkencor për Caqet e Ekspozimit në Vendin e Punës (SCOEL) ose Konferenca Amerikane e Higjienistëve Industrialë Qeveritarë (ACGIH). OEL-et konsiderohen si nivele ekspozimi të sigurta për një punëtor tipik në vendin e punës për një turn 8-orësh, javë 40-orëshe si mesatare të peshuar kohore (TWA) ose për një cak ekspozimi të shkurtër (STEL) prej 15 minutash. Edhe pse konsiderohen si mbrojtëse ndaj shëndetit, OEL-et përlllogariten me një proces të ndryshëm nga ai i REACH-it.

PËRQENDRIMI PA EFEKT I PARASHIKUAR (PNEC)

Emri i Lëndës	Ujë (ujë i ëmbël)	Ujë (ujë deti)	Ujë (çlirim i herëpashershëm)	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Zeza	Sedimenti	Truall	Oral (helmim dytësor)
Hidrokarbure, C11-C14, n-alkane, izoalkane, ciklike, <2% aromatike	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA

8.2. KONTROLLET E EKSPOZIMIT

KONTROLLE INXHINIERIKE

Niveli i mbrojtjes dhe llojet e nevojshme të kontrollit do të ndryshojnë në vartësi të rrethanave të ekspozimit të mundshëm. Masa kontrolli për t'u pasur parasysh:

Për të mbetur nën kufijtë e ekspozimit, përdorni pajisje ajrimi të përshtatshme për mjedise me rrezik shpërthimi.

MBROJTJE PERSONALE

Pajisjet e rekomanduara për mbrojtje personale ndryshojnë sipas rrethanave të ekspozimit të mundshëm, në vartësi të aplikimeve, praktikave të trajtimit, përqendrimit dhe ajrimit. Informacioni në vijim për përzgjedhjen e pajisjeve mbrojtëse që duhen përdorur me këtë material mbështetet në rrethana normale të përdorimit, sipas

indikacioneve.

Mbrojtje e Frymëmarrjes: Në rast se kontrollet inxhinierike nuk arrijnë ta mbajnë përqendrimin e kontaminantëve në një nivel të mjaftueshëm për të mos e rrezikuar shëndetin e punëtorëve, mund të lindë nevoja që të përdoret një aparat respirator i miratuar. Përzgjedhja, përdorimi dhe mirëmbajtja e aparateve respiratore duhet bërë në pajtim me kërkesat e rregulloreve, nëse ka të tilla. Llojet e aparateve respiratore për t'u marrë parasysh gjatë punës me këtë material janë:

Respirator me mbulim të fytyrës përgjysmë Material për filtër të llojit AP., Standardet EN 136, 140 dhe 405 të Komitetit Evropian të Standardizimit (CEN) rekomandojnë maska të frymëmarrjes, ndërsa EN 149 dhe 143 rekomandojnë filtra.

Në rast përqendrimesh të larta në ajër, përdorni një aparat respirator me furnizim ajri të miratuar, duke e regjistruar për funksionim në trysni pozitive. Aparatet respiratore me furnizim ajri dhe shishe shkarkimi mund të jenë të përshtatshme në ato raste kur nivelet e oksigjenit janë të pamjaftueshme, gazi ose avulli nuk janë të përshtatshëm për frymëthithje, ose kur kapaciteti/klasifikimi i filtrit ajërpastrues është i pamjaftueshëm.

Mbrojtje e Duarve: Të gjitha informacionet specifike për dorezat mbështeten në literaturën e botuar dhe të dhënat e prodhuesit të dorezave. Përshtatshmëria e dorezave dhe afati teknik i përdorimit ndryshojnë në vartësi të kushteve specifike të përdorimit. Lidhuni me prodhuesin e dorezave për t'u këshilluar në lidhje me cilat doreza këshillohen për kushtet tuaja të punës si dhe afatet përkatëse të përdorimit. Gjithnjë kontrollojini dorezat dhe zëvendësojini dorezat e konsumuara ose të dëmtuara. Llojet e dorezave që këshillohen të përdoren për këtë material përfshijnë:

Nëse ka gjasë për kontakt të zgjatur ose të përsëritur, këshillohet të përdoren doreza rezistente ndaj kimikateve. Nëse ka gjasë për kontakt me parakrahët, duhen përdorur doreza me mëngë. Nitril, ME një trashësi minimale prej 0.38 mm ose material barrierë mbrojtës i ngjashëm, me rendiment të lartë për kushte përdorimi me kontakt të vijueshëm dhe lejim depërtimi prej të paktën 480 minuta në pajtim me standardet CEN EN 420 dhe EN 374.

Mbrojtje e Syve: Nëse ka gjasë për kontakt, këshillohen syze sigurie me mburoja anësore. Gjatë aerosolizimit duhen përdorur syze mbrojtëse kimike.

Mbrojtje e Lëkurës dhe e Trupit: Të gjitha të dhënat specifike që jepen për veshjet (rrobet) mbështeten në literaturën e botuar dhe të dhënat e fabrikantëve. Llojet e veshjeve që duhen marrë në konsideratë për këtë material përfshijnë:

Nëse ka gjasë për kontakt të zgjatur ose të përsëritur, këshillohet përdorimi i veshjeve rezistente ndaj kimikateve dhe vajrave.

Masa Higjienike Specifike: Gjithnjë respektoni rregullat elementare të higjienës personale, të tilla si larja e duarve pasi ta keni prekur materialin ose para se të hani, të pini ose të tymosni duhan. Lajini rregullisht rrobet e punës dhe pajisjet mbrojtëse për të larguar që andej kontaminantët. Shkartisni veshmbathje të kontaminuara që nuk mund të pastrohen. Mbajeni pastër mjedisin e punës.

KONTROLLE MJEDISORE

Zbatoni rregulloret mjedisore përkatëse që kufizojnë shkarkimin në ajër, ujë dhe truall. Mbronni mjedisin duke marrë masa të përshtatshme kontrolli për të parandaluar ose kufizuar emisionet.

SEKSIONI 9

VETITË FIZIKE DHE KIMIKE

Shënim: Vetitë fizike dhe kimike jepen për qëllime sigurimi, shëndeti dhe mjedisore dhe mund të mos përfaqësojnë tërësisht karakteristikat teknike të produktit. Lidhuni me Furnizuesin për informacion të

mëtejshëm.

9.1. INFORMACION PËR VETITË FIZIKE DHE KIMIKE THEMELORE

Gjendja Fizike: Lëng
Ngjyra: Pa ngjyrë
Kundërmimi: Karakteristik
Pragu i Kundërmimit: Nuk disponohen të dhëna
Pika e Shkrirjes / Pika e Ngrirjes: Nuk mund të kryhet teknikisht / Nuk disponohen të dhëna
Pika e Vlimit Fillestar / dhe Intervali i Vlimit: 195°C (383°F) - 275°C (527°F) [ASTM D86]
Ndezshmëria (E ngurtë, Gaz): Nuk mund të kryhet teknikisht
Kufiri i poshtëm dhe i sipërm i shpërthimit: UEL (Kufiri i Sipërm i Ekspozimit): Nuk disponohen të dhëna
LEL (Kufiri i Poshtëm i Ekspozimit): Nuk disponohen të dhëna
Pika e Flakërimit [Metoda]: >70°C (158°F) [ASTM D-93]
Temperatura e Vetëndezjes: Nuk disponohen të dhëna
Temperatura e Shpërbërjes: Nuk disponohen të dhëna
pH: Nuk disponohen të dhëna
Viskoziteti kinematik: 2.3 cSt (2.3 mm²/sek) në 40 °C [metoda e testimit nuk disponohet]
Tretshmëria: I papërfillshëm
Koeficienti i ndarjes (Koeficienti i Ndarjes n-Oktanol/Ujë): > 3.5 [I përafuar]
Trysnia e Avullit: < 0.1 kPa (0.75 Mm Hg) në 20 °C [I përafuar]
Dendësia Relative (në 15 °C): 0.862 [ASTMD4052]
Densiteti relativ i avullit (Ajër = 1): > 2 në 101 kPa [I përafuar]
Shpejtësia e Avullimit (n-butil acetat = 1): Nuk disponohen të dhëna
Vetitë Shpërthyese: Asnjë
Vetitë Oksiduese: Asnjë
Karakteristikat e grimcave
Madhësia mesatare e grimcave: Nuk Zbatohet

9.2. TË DHËNA TË TJERA

Pika e Derdhjes: 0°C (32°F) [ASTM D97]

9.2.1. INFORMACIONET LIDHUR ME KATEGORITË E RREZIQEVE FIZIKE

Nuk disponohen të dhëna

9.2.2. KARAKTERISTIKA TË TJERA TË SIGURISË

Nuk disponohen të dhëna

SEKSIONI 10

QËNDRUESHMËRIA DHE REAKTIVITETI

10.1. REAGUESHMËRIA: Shihni nën-seksionet më poshtë.

10.2. QËNDRUESHMËRIA KIMIKE: Materiali është i qëndrueshëm në rrethana normale.

10.3. MUNDËSI REAKSIONESH TË RREZIKSHME: Nuk do të ndodhë polimerizim i rrezikshëm.

10.4. RRETHANA PËR T'U SHMANGUR: Shmangni burime nxehësie, shkëndija, flakë të gjalla dhe burime të tjera ndezëse.

10.5. MATERIALE TË PAPAJTUESHME: Oksidues të fortë

Emri i produktit: WYROL 6
 Data e rishikimit: 29 Dhj 2022
 Faqe 10 nga 16

10.6. PRODUKTE TË RREZIKSHME TË SHPËRBËRJES: Materiali nuk shpërbëhet në temperaturën e mjedisit.

SEKSIONI 11 TË DHËNA TOKSIKOLOGJIKE

11.1. INFORMACIONET PËR KATEGORITË E RREZIQEVE SIÇ PËRCAKTOHEN NË RREGULLOREN (KE) NR 1272/2008

Klasa e rrezikshmërisë	Përfundime / Vërejtje
Frymëthithje	
TOKSICITETI AKUT: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Minimalisht Toksik. Në bazë të vlerësimit të përbërësve.
Irritim: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Temperaturat e larta ose veprimi mekanik mund të krijojnë avuj, aerosol, ose tymra që mund të irritojnë sytë, hundën, fytin ose mushkëritë.
GËLLTITJA	
TOKSICITETI AKUT: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Minimalisht Toksik. Në bazë të vlerësimit të përbërësve.
Lëkurë	
TOKSICITETI AKUT: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Minimalisht Toksik. Në bazë të vlerësimit të përbërësve.
Gërryerje e Lëkurës/Irritim: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Mund të përthajë lëkurën, duke çuar në bezdi dhe dermatitis. Në bazë të vlerësimit të përbërësve.
Sy	
Dëmtime Serioze të Syve/Irritim: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Mund të shkaktojë ngacmim të lehtë e për një kohë të shkurtër të syve. Në bazë të vlerësimit të përbërësve.
Përndjeshmimi	
Përndjeshmimi i Rrugëve të Frymëmarrjes: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Nuk pritet të jetë përndjeshmues i rrugëve të frymëmarrjes.
Përndjeshmimi i Lëkurës: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Nuk pritet të jetë përndjeshmues i lëkurës. Në bazë të vlerësimit të përbërësve.
Aspirim: Të dhënat që disponohen.	Mund të jetë fatale po të gëlltitet dhe të depërtojë në rrugët e frymëmarrjes. Bazuar në vetitë fiziko-kimike të materialit.
Mutagjeniteti për Qelizat Gjerminalë: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Nuk pritet të jetë mutagjen i qelizave gjerminalë. Në bazë të vlerësimit të përbërësve.
Kancerogjeniteti: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Nuk pritet të shkaktojë kancer. Në bazë të vlerësimit të përbërësve.
Toksiciteti Riproduktiv: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Nuk pritet të jetë toksikant riprodaktiv. Në bazë të vlerësimit të përbërësve.
Laktacioni: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Nuk pritet të shkaktojë dëmtime në fëmijët që ushqehen me qumësht gjiri.
Toksiciteti Specifik për Organin e Shënjestruar (STOT)	
Ekspozimi Një Herë: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Nuk pritet të shkaktojë dëmtime të organeve me një ekspozim të vetëm.
Ekspozimi i Përsëritur: Nuk ka të dhëna të pikëmbylljes për materialin.	Nuk pritet të shkaktojë dëmtime të organeve pas ekspozimit të gjatë ose të përsëritur. Në bazë të vlerësimit të përbërësve.

11.2. INFORMACIONET PËR RREZIQET E TJERA

11.2.1 VETITË ÇRREGULLUESE ENDOKRINE

Nuk përmban asnjë substancë që njihet për vetitë çrregulluese endokrine, të cilat prekin shëndetin e njerëzve.

Emri i produktit: WYROL 6
Data e rishikimit: 29 Dhj 2022
Faqe 11 nga 16

11.2.2 TË DHËNA TË TJERA

Për produktin vetë:

Përqendrimet e avullit mbi nivelet e këshilluara të ekspozimit janë irrituese për sytë dhe rrugët e frymëmarrjes, mund të shkaktojnë dhimbje koke dhe marrje mendsh, janë anestetike dhe mund të kenë efekte të tjera ndaj sistemit nervor qendror. Kontakti i zgjatur dhe/ose i përsëritur i lëkurës me materiale me viskozitet të ulët mund të shkaktojë çyndyrim të lëkurës dhe të çojë në irrim të mundshëm dhe dermatit. Sasi të vogla lëngu të aspiruara në mushkëri gjatë qëllitjes ose të vjellit mund të shkaktojë pneumoni kimike ose edemë mushkërore.

SEKSIONI 12 TË DHËNA MJEDISORE

Informacioni i dhënë bazohet në të dhëna për materialin, përbërësit e materialit ose materiale të ngjashme, përmes zbatimit të parimeve bashkuese.

12.1. TOKSICITETI

Material -- Pritet të jetë shumë toksik për gjallesat ujore. Mund të shkaktojë efekte të padëshirueshme afatgjata në mjedisin ujor.

12.2. PERSISTENCA DHE DEGRADUESHMËRIA

Biodegradimi:

Shumica e përbërësve -- Pritet të jetë menjëherë i biodegradueshëm.

Oksidimi Atmosferik:

Komponim hidrokarbur -- Pritet të degradojë me shpejtësi në kontakt me ajrin

12.3. POTENCIALI BIOAKUMULATIV

Komponim hidrokarbur -- Ka potencial për t'u bioakumuluar, por metabolizmi ose vetitë fizike mund t'ia reduktojnë biopërqendrimin ose t'ia kufizojnë biopërdorshmërinë.

12.4. LËVIZSHMËRIA NË TRUALL

Komponim hidrokarbur -- Tepër volatil, do të përndahet me shpejtësi të madhe në ajër. Nuk pritët të përndahet në lymra dhe mbetje të tjera të ngurta të ujërave të zeza.

Një komponent -- Pluskues dhe me tretshmëri të ulët, pritët të migrojë nga uji në tokë. Pritët në përndahet në lëndë të ngurta sedimentare dhe lymra.

12.5. REZULTATET E VLERËSIMIT TË PBT DHE vPvB

Materiali nuk i kënaq kriteret e Aneksit XIII të Reach për PBT ose vPvB.

12.6. VETITË ÇRREGULLUESE ENDOKRINE

Nuk përmban asnjë substancë që njihet për vetitë çrregulluese endokrine, të cilat ndikojnë në mjedis.

12.7. EFEKTE TË TJERA TË PADËSHIRUESHME

Nuk pritët të ketë efekte të padëshirueshme.

SEKSIONI 13 KONSIDERATA PËR SHKARTISJEN

Rekomandimet për shkartisje mbështeten në materialin ashtu siç ofrohet. Shkartisja duhet bërë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në fuqi, dhe karakteristikat e materialit në momentin e shkartisjes.

13.1. METODA TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE

Emri i produktit: WYROL 6

Data e rishikimit: 29 Dhj 2022

Faqe 12 nga 16

Produkti është i përshtatshëm për t'u djegur në një furrë të mbyllur e të kontrolluar si burim energjie ose për t'u shkartisur nëpërmjet shkurbimit të mbikqyrur në temperatura shumë të larta për të parandaluar formimin e nënprodukteve të padëshirueshme të djegies.

Kodi Evropian i Mbetjeve: 12 01 07*

SHËNIM: Këto kode caktohen në bazë të përdorimeve më të zakonshme për këtë material dhe mund të mos marrin parasysh kontaminantët që i detyrohen përdorimit konkret. Kur përftojnë mbetjen dhe kontaminantët përkatës, përfuesit e mbetjeve duhet të vlerësojnë procesin konkret që është përdorur, me qëllim caktimi të kodeve përkatëse të shkartisjes së mbetjeve.

Ky material konsiderohet si një mbetje e rrezikshme sipas direktivës 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Për mbetjet" dhe që shfuqizon disa direktiva, dhe i nënshtrohet dispozitave të kësaj direktive, përveç nëse zbatohet neni 20 i saj.

Lajmërim për Kontejner të Zbrazët Paralajmërim për Enët e Zbrazëta (atje ku gjen zbatim): Enët e zbrazëta mund të përmbajnë mbeturina të materialit dhe të paraqitin rrezik. Mos u orvatni t'i rimbushni ose t'i pastroni këto enë pa ndjekur udhëzimet përkatëse. Bucelat e zbrazëta duhet të lihen të kullojnë mirë dhe pastaj të ruhen në një vend të sigurtë derisa të rikushtëzohen ose të eliminohen në rrugë të përshtatshme. Enët e zbrazëta duhen çuar për riciklim, rekuperim ose eliminim vetëm nëpërmjet një kontraktori të kualifikuar ose të licensuar për këtë veprimtari, dhe në pajtim me rregulloret qeveritare. MOS I PRESURIZONI, PRISNI, ELEKTROSALDONI, SALDONI ME NGJITJE TË BUTË OSE TË NGURTË, SHPONI, BLUANI OSE EKSPONIZONI ENË TË TILLA NDAJ NXEHTËSISË, FLAKËVE, SHKËNDIJAVE, ELEKTRICITETIT STATIK, OSE BURIMEVE TË TJERA NDEZËSE. MUND TË SHPËRTHEJNË DHE TË SHKAKTOJNË LËNDIME OSE VDEKJE.

SEKSIONI 14**TË DHËNA PËR TRANSPORTIN**

TOKËSOR (ADR ose Marrëveshja për Transportin Rrugor të Mallrave të Rrezikshme/RID ose Marrëveshja për Transportin Hekurudhor të Mallrave të Rrezikshme)

14.1. Numri UN (ose ID): 3082**14.2. Emri i përshtatshëm për transportim UN (Emri Teknik):** LËNDË ME RREZIKSHMËRI PËR MJEDISIN, E LËNGSHME, E PASPECIFIKUAR NDRYSHE (Laurat Metili)**14.3. Klasa(t) e Rrezikshmërisë për Transport:** 9**14.4. Grupi i ambalazhimit:** III**14.5. Rrezikshmëritë mjedisore:** Po**14.6. Masa Parambrojtëse të Posaçme për përdoruesit:****Kodi i Klasifikimit:** M6**Etiketa(t)/Shenja(t):** 9, EHS**Numri ID i Rrezikshmërisë:** 90**Kodi Hazchem EAC (Kodi i Veprimit Urgjent):** 3Z

RRUGËT UJORE TË BRENDSHME (ADN)

14.1. Numri UN (ose ID): 3082**14.2. Emri i përshtatshëm për transportim UN (Emri Teknik):** LËNDË ME RREZIKSHMËRI PËR MJEDISIN, E LËNGSHME, E PASPECIFIKUAR NDRYSHE (Laurat Metili)**14.3. Klasa(t) e Rrezikshmërisë për Transport:** 9**14.4. Grupi i ambalazhimit:** III**14.5. Rrezikshmëritë mjedisore:** Po**14.6. Masa Parambrojtëse të Posaçme për përdoruesit:**

Emri i produktit: WYROL 6
Data e rishikimit: 29 Dhj 2022
Faqe 13 nga 16

Numri ID i Rrezikshmërisë: 90
Etiketa(t)/Shenja(t): 9, EHS

DETAR (IMDG ose Mallra të Rrezikshme për Transportin Detar Ndërkombëtar)

14.1. Numri UN (ose ID): 3082
14.2. Emri i përshtatshëm për transportim UN (Emri Teknik): LËNDË ME RREZIKSHMËRI PËR MJEDISIN, E LËNGSHME, E PASPECIFIKUAR NDRYSHE (Laurat Metili)
14.3. Klasa(t) e Rrezikshmërisë për Transport: 9
14.4. Grupi i ambalazhimit: III
14.5. Rrezikshmëritë mjedisore: Ndotës Detar
14.6. Masa Parambrojtëse të Posaçme për përdoruesit:
Etiketë/a: 9
Numri EMS: F-A, S-F
Emri i Dokumentit të Transportit: UN3082, LËNDË TË RREZIKSHME PËR MJEDISIN, TË LËNGSHME, TË PASPECIFIKUARA NDRYSHE (Laurat metili), 9, PG III, NDOTËS DETAR

Shënim: Nuk u nënshtrohet dispozitave të UN3082 Substanca të lëngshme me rrezikshmëri për mjedisin, të paspecifikuara ndryshe, po të transportohet në sasi prej 5 litrash ose më pak për paketime individuale ose me kombinim të brendshëm sipas kodit IMDG 2.10.2.7.

SEA (MARPOL 73/78 Convention - Annex II):

14.7. Transport detar në masë sipas instrumenteve të IMO-s
Jo i Klasifikuar sipas Shtojcës II

AJROR (IATA ose Shoqata e Transportit Ajror Ndërkombëtar)

14.1. Numri UN: 3082
14.2. Emri i përshtatshëm për transportim UN (Emri Teknik): LËNDË ME RREZIKSHMËRI PËR MJEDISIN, TË LËNGSHME, TË PASPECIFIKUARA NDRYSHE (Laurat Metili)
14.3. Klasa(t) e Rrezikshmërisë për Transport: 9
14.4. Grupi i ambalazhimit: III
14.5. Rrezikshmëritë mjedisore: Po
14.6. Masa Parambrojtëse të Posaçme për përdoruesit:
Etiketa(t)/Shenja(t): 9, EHS
Emri i Dokumentit të Transportit: UN3082, LËNDË TË RREZIKSHME PËR MJEDISIN, TË LËNGSHME, TË PASPECIFIKUARA NDRYSHE (Laurat metili), 9, PG III

[Shënim: Nuk u nënshtrohet dispozitave të UN3082 Substanca të lëngshme me rrezikshmëri për mjedisin, të paspecifikuara ndryshe, po të transportohet në sasi prej 5 litrash ose më pak për paketime individuale ose me kombinim të brendshëm sipas Dispozitës Speciale A197.]

SEKSIONI 15 TË DHËNA RREGULLATORE

STATUSI RREGULLATOR DHE LIGJET E RREGULLORET E ZBATUESHME

I listuar ose i përjashtuar nga listimi/njoftimet në inventarët kimikë të mëposhtëm : AIIC, DSL, ENCS, IECS, ISHL, KECI, PICCS, TCSI, TSCA

15.1. RREGULLORET E SIGURISË, SHËNDETIT DHE MJEDISIT/LEGJISLACION SPECIFIK PËR LËNDËN OSE

Emri i produktit: WYROL 6
Data e rishikimit: 29 Dhj 2022
Faqe 14 nga 16

PËRZIERJEN

Direktiva dhe Rregullore BE të zbatueshme:

1907/2006 [... për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve ... dhe amendamentet përkatëse]

2004/42/CE [për kufizimin e emisioneve të komponimeve organike volatile që i detyrohen përdorimit të tretësve organikë në disa bojëra, vernikë dhe produkte për rifiniturë automjetesh dhe Direktiva amenduese 1999/13/EC.]

96/82/EC i zgjeruar nga 2003/105/EC [... rreth kontrollit të aksidenteve madhore që përfshijnë lëndë të rrezikshme]. Produkti përmban një lëndë që plotëson kriteret e përcaktuara në Aneksin I. Referojuni Direktivës për hollësi në lidhje me kushtet, duke marrë parasysh vëllimin e produktit të magazinuar në kantier.

98/24/EC [... për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet e ekspozimit ndaj agjentëve kimikë në vendin e punës ...]. Referojuni Direktivës për hollësi rreth kushteve.

1272/2008 [në klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhin e lëndëve dhe përzierjeve.. dhe amendimeve përkatëse]

Kufizimet e REACH për prodhimin, hedhjen në treg dhe përdorimin e disa substancave, përzierjeve dhe artikujve të rrezikshëm (Shtojca XVII):

Zërat në vijim të Shtojcës XVII mund të merren parasysh për këtë produkt: None

15.2. VLERËSIMI I SIGURISË KIMIKE

Informacioni REACH: Për një ose më shumë nga lëndët që përmban materiali është kryer Vlerësimi i Sigurisë Kimike.

SEKSIONI 16

TË DHËNA TË TJERA

REFERENCAT: Burimet e informacionit që janë përdorur për të përgatitur këtë SDS përfshijnë një ose më shumë nga sa vijon: rezultate nga studime toksikologjike të brendshme ose të furnizuesit, CONCAWE Product Dossiers, botime nga shoqata të tjera profesionale, të tilla si EU Hydrocarbon Solvents REACH Consortium, U.S. HPV Program Robust Summaries, Databaza EU IUCLID, Botimet NTP në ShBA, dhe burime të tjera sipas rastit.

Lista e shkurtimeve dhe akronimeve që mund të jenë përdorur (por jo që janë përdorur patjetër) në këtë dëftesë të sigurisë teknike:

Akronimi	Teksti i plotë
N/A	Nuk zbatohet
N/D	I pacaktuar
NE	Nuk është përcaktuar
VOC (Komponim Organik Volatil)	Komponim Organik Volatil
AICC	Inventari Australian për Lëndët Kimike Industriale
AIHA WEEL (Kufiri i Ekspozimit Mjedisor në Vendin e Punës, sipas Shoqatës Amerikane të Higjienës)	Kufijtë e Ekspozimit Mjedisor në Vendin e Punës për Shoqatën e Higjienës Industriale Amerikane

Emri i produktit: WYROL 6

Data e rishikimit: 29 Dhj 2022

Faqe 15 nga 16

Industriale)	
ASTM	ASTM International, e njohur më parë si American Society for Testing and Materials (ASTM ose Shoqata Amerikane për Testime dhe Materiale)
DSL	Lista e Lëndëve Kombëtare (Kanada)
EINECS	Inventari Europian i Lëndëve Komerciale Ekzistuese
ELINCS (Lista Evropiane e Lëndëve Kimike të Njoftuara)	Lista Europiane e Lëndëve Kimike të Raportuara
ENCS	Lëndë Kimike Ekzistuese dhe të Reja (Inventari Japonez)
IECSC	Inventari i Lëndëve Kimike Ekzistuese në Kinë
KECI (Inventar i Kimikateve Ekzistuese në Kore)	Inventari Korean i Kimikateve Ekzistuese
NDSL	Lista e Lëndëve Jo-Kombëtare (Kanada)
NZIoC	Inventari i Kimikateve i Zelandës së Re
PICCS (Inventari Filipinas i Kimikateve dhe Lëndëve Kimike)	Inventari Filipinas i Kimikateve dhe Lëndëve Kimike
TLV	Vlera Limit e Pragut (Konferenca Amerikane e Higjienistëve Industrialë Qeveritarë)
TSCA	Akti i Kontrollit të Lëndëve Toksike (inventari ShBA)
UVCB	Lëndë me përbërje të Panjohur ose të Ndryshueshme, produkte me reagueshmëri Komplekse ose materiale Biologjike
LC	Përqendrimi Letal
LD	Doza Letale
LL	Ngarkesa Letale
EC	Përqendrimi Efektiv
EL	Ngarkesa Efektive
NOEC	Nuk ka Përqendrim me Efekt të Vrojtueshëm
NOELR	Nuk ka Shpejtësi të Ngarkimit të Efektit të Vrojtueshme

Klasifikimi sipas Rregullores (EC) No. 1272/2008

Klasifikimi sipas Rregullores (EC) No. 1272/2008	Procedura e klasifikimit
Aquatic Acute 1; H400	Përlllogaritja
Aquatic Chronic 2; H411	Përlllogaritja
Asp. Tox. 1; H304	Bazuar në të dhënat e testit

LEGJENDA PËR KODET H QË PËRMBAHEN NË SEKSIONIN 3 TË KËTIJ DOKUMENTI (vetëm për informacion):

[Lng. Ndez. 4 H227]: Lëng i djegshëm; Lëng i Ndezshëm, Kat 4

Asp. Toks. 1 H304: Mund të jetë fatale po të gëlltitet dhe të depërtojë në rrugët e frymëmarrjes; Aspirim, Kat. 1

Ujor Akut 1 H400: Shumë toksik për gjallesat ujore; Toks. Mjed. Akut, Kat. 1

Ujor Kronik 1 H410: Shumë toksik për gjallesat ujore me efekte afatgjata; Toks. Mjed. Kronik, Kat. 1

Ujor Kronik 2 H411: Toksik për gjallesat ujore me efekte afatgjata; Toks. Mjed. Kronik, Kat. 2

EUH066: Ekspozimi i përsëritur mund të shkaktojë tharje ose plasaritje të lëkurës.

KJO DËFTESË E SIGURISË TEKNIKE PËRMBAN RISHIKIMET E MËPOSHTME:

Përbërja: Tabela e Përbërësve për REACH informacioni është ndryshuar.

Seksioni 08: Tabela e Kufijve të Ekspozimit informacioni është ndryshuar.

Seksioni 09 Madhësia mesatare e grimcave informacioni është shtuar .

Seksioni 09: Pika e ngrirjes C(F) informacioni u hoq.

Emri i produktit: WYROL 6

Data e rishikimit: 29 Dhj 2022

Faqe 16 nga 16

Seksioni 09: Pika e shkrirjes C(F) informacioni u hoq.

Seksioni 11 Shtojca II e BE-së Të dhënat e çrregulluesit endokrin informacioni është shtuar .

Seksioni 12 Shtojca II e BE-së Të dhënat e çrregulluesit endokrin informacioni është shtuar .

Seksioni 13: Shënim Rrezikshmërie për Kodet Europiane të Mbetjeve informacioni është ndryshuar.

Seksioni 2 Shtojca II e BE-së Të dhënat e çrregulluesit endokrin informacioni është shtuar .

Seksioni 9 Pikat e shkrirjes dhe të ngrirjes informacioni është shtuar .

Të dhënat dhe rekomandimet e këtushme janë, me sa di dhe beson ExxonMobil, të përpikta dhe të besueshme që prej datës së botimit. Ju mund të lidheni me ExxonMobil për t'u siguruar që ky dokument është më i fundit në zotërim të ExxonMobil. Të dhënat dhe rekomandimet ofrohen për t'u pasur parasysh dhe për t'u shqyrtuar nga përdoruesi. Është përgjegjësi e përdoruesit që të sigurohet se produkti i përshtatet përdorimit përkatës. Nëse blerësi e riambalazhon këtë produkt, është përgjegjësi e përdoruesit të sigurohet që të dhënat e duhura për shëndetin, sigurinë dhe të tjera të nevojshme janë afishuar në kontejner ose e shoqërojnë atë. Përdoruesve dhe trajtuesve të materialit u duhen bërë të ditura paralajmërimet e nevojshme dhe procedurat e trajtimit të sigurtë. Modifikimi i këtij dokumenti ndalohet rreptësisht. Me përjashtim të çfarë kërkohet me ligj, ribotimi ose ritransmetimi i këtij dokumenti, në tërësi ose pjesërisht, nuk lejohen. Termi "ExxonMobil" përdoret për lehtësi përdorimi dhe mund t'i referohet ExxonMobil Chemical Company, ExxonMobil Corporation, ose filialeve të ndryshme ku ato marrin pjesë me kapital.

Vetëm për Përdorim të Brendshëm

MHC: 1A, 0, 0, 0, 1, 1

PPEC: C

DGN: 2026629XAL (555353)

SHTOJCA

Shtojca nuk kërkohet për këtë material.